



BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

## PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 18-24 MUAJ MUAJI TETOR



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

<http://femijetiranes.al/>

 Fëmijët e Tiranës

 femijet\_e\_tiranes

## “Karakteristika të Stinës së Vjeshtës”



### Çfarë duhet të dimë për Vjeshtën?

- \* Vjeshta është një nga katër stinët e bukura të vitit ku natyra merr një pamje përrallore.
- \* Karakteristikë e stinës së vjeshtës është zverdhja e gjetheve dhe rënia e tyre në tokë.
- \* Në vjeshtë, dita nis të bëhet më e shkurtër dhe nata vjen më shpejt.
- \* Në vjeshtë, shumë kafshë fillojnë të përgatiten për stinën e dimrit duke mbledhur dhe ruajtur ushqimin nëpër fole dhe strofka.

## Muaji Tetor – Tema Mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës

### Grupi paslatant: 18-24 muaj

- \* **Java I:** Karakteristikat e përgjithshme të stinës së vjeshtës
- \* **Java II:** Njohja me elementë kryesorë të stinës së vjeshtës
- \* **Java III:** Njohja e frutave dhe perimeve të stinës së vjeshtës
- \* **Java IV:** Veshja në vjeshtë



### Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës



Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Karakteristika të përgjithshme të stinës	Njohja me elementët kryesorë të stinës si: moti në vjeshtë, shiu, era.	Java I
Njohja me elementët kryesorë të stinës	Njohja me disa elementë kryesorë si: dielli, qielli, shiu përmes punimeve të vizatimit.	Java II
Njohja e frutave dhe perimeve të stinës	Njohja e frutave, perimeve përmes demonstrimit të përgatitjes së ushqimeve.	Java III
Veshja në vjeshtë	Si vishemi në vjeshtë? Ndryshimi nga veshjet e lehta të verës tek ato më të ngrohtat.	Java IV





#### **Shënim:**

- \* Stafii edukator duhet ta realizojë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim asimilimin sa më thjeshtë të njohurive nga fëmijët.
- \* Stafii edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.

**Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës**  
**Tema e javës: Njohja me Karakteristika të Përgjithshme të Stinës**







Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<b>E Hënë</b>	Karakteristikat kryesore të stinës së vjeshtës 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon fëmijëve rreth karakteristikave kryesore të stinës si: shiu, era, retë, rënia e gjetheve etj. Si ndryshon moti nga vera në vjeshtë? Si është qielli? Si vishemi?</p> <p><b>Shëtitje:</b> Në oborr me fëmijët për të parë, prekur, mbledhur gjethe/degëza peme.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Vjeshta”</p> <p><b>Loja:</b> “Pikturimi me gishta – mbi ngjyrat e vjeshtës”.</p>	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave 
<b>E Martë</b>	Pasqyrimi i karakteristikave përmes vizatimit	<p><b>Vizatimi/ Ngjyrosja:</b> E figurave nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatorët si: forma të reve, të gjetheve, pemëve etj.</p> <p><b>Krijimi i tablosë:</b> Ngjitja e gjetheve të mbledhura në oborr (gjatë shëtitjes në ditën e hënë).</p> <p><b>Vjersha:</b> “Vjeshta”</p> <p><b>Këngë:</b> Këngë lëvizore 1</p>	Mjete Didaktike Manuali i Vjershave
<b>E Mërkurë</b>	Ngjyrat e vjeshtës	<p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon fëmijëve mbi ngjyrat referuar punimeve të ditëve të mëparshme ose përmes ilustrimit të figurave të tjera (revista, punime që disponojnë në grup, etj).</p> <p><b>Vjersha:</b> “Vjeshta”</p>	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave






		<p><b>Loja:</b> “Pikturimi me gishta – mbi ngjyrat e vjeshtës”</p> <p><b>Krijim:</b> Krijimi i pemës apo gjetheve me plastelinë me ngjyrat e vjeshtës. Krijimi i formave/figurave të ndryshme përmes gjetheve</p> <p><b>Këngë lëvizore:</b> “Një elefant po kolovitet”</p>	
<b>E Enjte</b>	<p>Pemët dhe gjethet në vjeshtë</p> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon/ demonstroi fëmijëve përmes materiale të ndryshme mbi pemët, degët dhe gjethet. Ajo i pyet fëmijët: Si janë ngjyrat e tyre? Cilat ngjyra janë njëllorj? Kush janë gjethet më të mëdha/të vogla?</p> <p><b>Vjersha:</b> “Vjeshta”</p> <p><b>Vizatimi/Ngjyrosje:</b> Pemët &amp; Gjethet e formave, modeleve të përgatitura më parë nga edukatorët.</p> <p><b>Lojra të lira:</b> “Me formuese, me birila, puzzle etj”.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> 
<b>E Premte</b>	<p>Përsëritja e aktiviteteve të javës</p>	<p><b>Bisedë:</b> Përsëritja mbi elementët e trajtuara gjatë javës.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Vjeshta”</p> <p><b>Përrallë e lirë</b> - ilustrim i figurave (sipas librave që disponojnë në grup).</p> <p><b>Loja:</b> Lojëra energjike, me top, birila, litare, pengesa.</p> <p><b>Këngë:</b> Këngë lëvizore 2.</p>	<p>Manuali i Vjershave Libra, revista</p>



**Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës**  
**Tema e javës: Njohja me Elementët Kryesorë të Stinës**



Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<b>E Hënë</b>	Qielli & Dielli në vjeshtë 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon fëmijëve mbi diellin, qiellin në stinën e vjeshtës. Ajo i pyet fëmijët: Si është qielli sot? Pse qielli është me re? Çfarë ngjyre ka qielli, dielli, retë?</p> <p>Ilustrimi përmes tablove, librave, revistave (të grupit).</p> <p><b>Shëtitje:</b> Në oborr me fëmijët ose të vështrohet dielli, qielli, retë nga dritarja.</p> <p><b>Vizatimi/Ngjyrosje:</b> “Dielli/Retë” (të ndarë në grupe)</p> <p><b>Përrallë e lirë:</b> Ilustrim i figurave(sipas librave që disponojnë në grup).</p>	Manuali i Vjershave Libra, revista 
<b>E Martë</b>	Ditë vjeshte me re dhe shi 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon fëmijëve sesi janë ditët në vjeshtë? - Me re/me shi.</p> <p><b>Punëdore:</b> Fëmijët punojnë me plastelinë/fletë punëdore “Retë”.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Shiu”</p> <p><b>Këngë :</b> “Rosat po lahen në liqën”</p> <p><b>Loja:</b> “Bërja e vulave” (në formë reje/çadre).</p>	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike 

<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p>Ditë shiu</p> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon fëmijëve rreth shiut, kur i përdorim çadrat.  <b>Çfarë ngjyre ka çadra juaj/Me çfarë personazhi?</b>  <b>Vjersha:</b> “Shiu”  <b>Loja:</b> “Ngjitësi që pikon dhe piktura me oriz”(punimi i çadrës).  <b>Këngë:</b> “Macja le të lahet”</p>	<p>Manuali i Vjershave  Manuali i Lojrave</p> 
<p><b>E Enjte</b></p>	<p>Çadra ime</p> 	<p><b>Aktivitet i improvizuar:</b> “Kam dhe unë çadrën time” - Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit që t’i pajisin fëmijët me çadra atë ditë – Fëmijët tregojnë / pyesin njëri-tjetrin për çadrën e tyre stimuluar nga edukatorja(shoqëruar me numërimin e çadrave dhe tregimin e ngjyrave të tyre).  <b>Vizatimi/ Ngjyrosje:</b> “Çadra- ngjyrosja e formave nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatorët.  <b>Vjersha:</b> “Shiu”.</p>	<p>Manuali i Vjershave  Mjete Didaktike</p> 
<p><b>E Premte</b></p>	<p>Përsëritja e aktiviteteve të javës</p>	<p><b>Bisedë:</b> Përsëritja mbi elementët e trajtuara gjatë javës.  <b>Vjersha:</b> “Shiu”  <b>Përrallë e lirë</b> - ilustrim i figurave( sipas librave që disponojnë në grup).  <b>Loja:</b> “Bërja e vulave”.</p>	<p>Manuali i Vjershave  Libra, revista</p> 




## Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës

### Tema e javës: Frutat dhe Perimet e Stinës



Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<b>E Hënë</b>	Njohja me frutat	<p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë - Edukatorja u tregon fëmijëve/demonstron përmes formave plastike, tablove, librave, revistave frutat e stinës. Cilat janë? Cilat fruta pëlqeni? Cfarë ngjyrash kanë? <b>Vjersha:</b> “Ngjyrat e mollës” <b>Vizatimi/ Ngjyrosja:</b> “Frutat”- ngjyrosja e formave nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatorët. <b>Loja:</b> “Tabela e lotos”(specifikisht me figura frutash). Bashkojmë frutat me të njëjtën ngjyrë.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libra, revista</p>
<b>E Martë</b>	Njohja me perimet	<p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon fëmijëve/demonstron përmes formave plastike, tablove, librave, revistave perimet e stinës. <b>Vjersha:</b> “Karrota” <b>Vizatimi/Ngjyrosja:</b> “Perimet”- ngjyrosja e formave nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatorët. <b>Loja:</b> “Tabela e lotos”(specifikisht me figura perimesh). Bashkojmë perimet me të njëjtën ngjyrë.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libra, revista</p>







<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p>Përgatitja e ushqimeve</p>	<p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon/ pyet fëmijët kush gatuan në shtëpi? Po në çerdhe?  <b>Vizitë</b> - Në kuzhinë – shpjegon edhe teta kuzhinierja çfarë ushqimesh ka përgatitur për atë ditë.  <b>Loja:</b> “Frutat dhe perimet/ Bëj sikur gatuan”(me zgjedhje)  <b>Përralla:</b> “Lejleku dhe dhelpër”.</p>	<p>Manuali i Lojrave</p> 
<p><b>E Enjte</b></p>	<p>Etika e të ngrënit</p> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon fëmijëve si shtrohet tavolina?  Si të ndihmojmë mamin/ edukatoren në shtrimin e tavolinës?  Pse i lajmë duart para dhe pas ushqimit?  <b>Vjersha:</b> “Etika e të ngrënit/ Dreka” – (me zgjedhje)  <b>Loja:</b> “Bëj sikur gatuan”.</p>	<p>Manuali i Vjershave  Manuali i Lojrave</p>
<p><b>E Premte</b></p>	<p>Përgatitja e ëmbëlsirës</p>	<p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë - Edukatorja u tregon/pyet cilat ëmbëlsira na pëlqejnë?  Çfarë ëmbëlsirash bën mami, gjyshja në shtëpi?  <b>Loja:</b> “Numërojmë biskotat 1-5 / Brumi për të luajtur (improvizimi përgatitja e kekut)  <b>Panairi i frutave dhe ëmbëlsirave:</b> Edukatores të bashkëpunojnë me prindërit për të sjellë një frut ose një ëmbëlsirë të përgatitur në shtëpi.</p>	<p>Manuali i Vjershave  Manuali i Lojrave</p> 

## Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës

### Tema e javës: Veshja në vjeshtë



Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Veshja e fëmijëve në vjeshtë</p> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon/pyet fëmijët si vishemi? Pse veshim bluzë me mëngë të gjata? Pse veshim atlete/ këpucë? Pse vishemi më lehtë në verë dhe pak më trashë në vjeshtë? <b>Loja:</b> “Veshja”.Fëmijët tregojnë dhe emërtojnë veshjet e tyre dhe të njëri-tjetrit. <b>Vizatimi/ Ngjyrosja:</b> “Veshjet e fëmijëve”- ngjyrosja e formave nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatorët. <b>Përralla:</b> “Tre derrkucët”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>
E Martë	<p>Veshja për vajzat</p>	<p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon fëmijëve veshjet për vajzat në vjeshtë. Çfarë fustani/ triko/ geta/ streçe ke veshur ti....Ana...? <b>Loja:</b> Edukatorja bashkë me fëmijët përgatisin veshje për vajzat: fundi/fustani/triko(me copa/ fletë punëdore). <b>Loja:</b> “Veshja e kukullës”(improvizimi i veshjes së kukullës me veshjet e përgatitura nga aktiviteti i mësipërm). <b>Vjersha:</b> “Jam një vajzë simpatike”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p> 

<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p>Veshja për djemtë</p> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon fëmijëve veshjet për djemtë në vjeshtë. Çfarë pantallonash/ bluzë/ atlete ke veshur ti ...Gimi...?</p> <p><b>Loja:</b> Edukatorja bashkë me fëmijët përgatisin veshje për djemtë: pantallonat/ bluzë/ jelek (me copa/fletë punëdore).</p> <p><b>Loja:</b> “Veshja e kukullës/ Arushave”(improvizimi i veshjes së kukullës me veshjet e përgatitura nga aktiviteti i mësipërm).</p> <p><b>Vjersha:</b> “Gimi i vogël”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>
<p><b>E Enjte</b></p>	<p>Ekspozita e veshjeve</p>	<p><b>Loja:</b> Paraqitja në tablo e veshjeve/ mini-ekspozitë të përgatitura në grup ose të sjella nga vetë fëmijët. Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit për të sjellë veshje të tyre në çerdhe.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Jam një vajzë simpatike”</p> <p><b>Përralla:</b> “Masha dhe ariu”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Veshje të ndryshme</p> 
<p><b>E Premte</b></p>	<p>Përsëritja e aktiviteve të javës</p>	<p><b>Bisedë:</b> Përsëritja mbi elementët e trajtuara gjatë javës.</p> <p><b>Loja:</b> “Veshja e kukullës””(improvizimi i veshjes së kukullës me veshjet e përgatitura gjatë javës).</p> <p><b>Vjersha:</b> “Jam një vajzë simpatike/Gimi i vogël”</p> <p><b>Përralla:</b> “Rosaku i shëmtuar”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>